



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTAR



Tiranë, më 26/05/2025

VENDIM

Nr.17, datë 26.05.2025

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, **Këshilli Kombëtar**, në lidhje me kandidaturat për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut

VENDOSI:

1. Të miratojë me 9 (nëntë) vota pro, se kandidatura e Znj. Anxhela Radovani nuk plotëson kriteret ligjore për vijimin e kandidimit në kategorinë Shërbime mbështetur në arsyetimin se:

Kandidatja Znj. Radovani nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 17, pika 1 të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, pasi nuk ka mbi 5 vjet eksperiencë pune si psikologe dhe aktualisht nuk ushtron profesionin e psikologut. Shkronja ç) e pikës 1 të nenit 16 përcakton se për këtë kategori mund të kandidojnë “psikologë që punojnë në shkolla, spitale, burgje, institucione komunitare, gjykatë, në zyra apo agjenci private, institucione rezidenciale, si dhe institucione varësie”, pra kriteri i vecantë i kërkuar është që kandidati duhet të ushtrojë aktualisht profesionin si psikologë në një nga këto institucione. Në rastin konkret, kandidatja nuk ushtron profesionin si psikologë, por është në një detyrë administrative, siç është pozicioni “Drejtor”. Në vijim, rezulton se kandidatja ka mbajtur këtë pozicion administrativ që nga viti 2017, pra, që nga ky vit, kandidja nuk ka ushtruar profesionin e psikologut, por detyrën administrative “Drejtor”, duke patur kështu më pak se 5 vjet pune tërësore në psikologji, pra, duke mos përmbushur as kriterin e përgjithshëm, të përcaktuar nga neni 17.1.c) i ligjit.

PRESIDENTE E URDHRI
Dr. Valbona TRESKA

SEKRETARE
Arlinda KËRÇI



Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë
email: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927